

# A do të shkojë Pupu në cirk?



Për klasën e tretë të arsimit fillor



# A do të shkojë Pupu në cirk?

## **Fjalët kyçe:**

përcaktimi i qëllimit financiar, kursimet, shpenzimet, libri i kursimeve, dhurimi, buxheti.

## **Udhëzime për punë me librin.**

### **Para leximit: Bisedë me fëmijët:**

- Sa para i shpenzoni gjatë javës?
- Sa arka kursimi keni dhe si duken ato?
- A keni planifikuar çfarë do të bëni me kursimet tuaja?

### **Gjatë leximit: Bisedë me fëmijët:**

- Nxitni fëmijët të flasin për atë çfarë shohin në ilustrim.
- Përdorni pyetjet: Çfarë po shihni? Pse është....? Ku ...? etj.
- Pas çdo faqeje të lexuar bisedoni për atë se çfarë ka ndodhur.
- Nxitni fëmijët të parashikojnë se çfarë do të ndodhë në faqen tjetër pa e shfletuar ende.
- Kërkoni nga fëmijët që të gjejnë fjalë të ngjashme me disa nga fjalët e reja në tekst.

### **Pas leximit: Bisedë me fëmijët:**

- Shih faqen 4 dhe 5 dhe trego: Sa arka i duhen Pupu?
- Shih faqen 6 dhe 7 dhe trego: Çfarë po planifikonin Pupu dhe Mimi?
- Shih faqen 8 dhe 9 dhe trego: Cili ishte gabimi i Pupu?
- Shih faqen 12 dhe 13 dhe trego: Si mundi ta përmirësojë gabimin Pupu?
- Çfarë do të ndodhte nëse Pupu dhe Mimi nuk do të mund t'i kthenin paratë në arka?
- Përse është i rëndësishëm planifikimi i kursimeve, shpenzimeve dhe dhurimeve? Trego nga një shembull për secilin nga ato.





- Që në mëngjes, Pupu ishte ngritur dhe po kërkonte nën shtrat një ngjyrë druri.
- Nënë, po e shoh një libër nën shtrat, - u dëgjua zëri i tij.
- Oh Pupu, është libri im. Mbrëmë më zuri gjumi duke shkruar dhe duket se ka rënë aty, - ia ktheu nëna.
- Për çfarë të duhet ai? – pyeti me kureshtje Pupu.
- Libri i kursimeve? pyeti nëna. Aty kam shënimet e gjithë atyre sa shpenzojmë, sa kursejmë, sa dhurojmë dhe sa investojmë, - i shpjegoi ajo.



- Edhe ti duhet të kesh një të tillë – e këshilloi nëna. – Vetëm ashtu mund të kontrollosh buxhetin tënd, - tha ajo.
- A mund të filloj që tani me paratë e xhepit të kësaj jave? – pyeti Pupu.
- Po, patjetër. Së pari, përveç arkës së kursimeve, na duhen edhe dy arka tjera, një për shpenzime dhe një për dhurim.
- Dhurim?! – u habit Pupu.





- Po Pupu. Ne të gjithë duhet të dhurojmë nga pak për ata që kanë nevojë,
- shpjegoi nëna.
- Ti mund t'i ndash për çdo javë nga 2 euro për shpenzime, 1 euro për kursime dhe 50 cent për dhurim.
- Gjysmat! Kjo qenka si thyesat që i mësojmë ne në shkollë, – qeshi Pupu.
- Ti duhet të mbash shënime në librin e kursimeve për çdo para që vendos në arkë, – e këshilloi atë nëna.
- Faleminderit nënë! – e përqafoi Pupu.
- Duhet të kesh kujdes Pupu, të mos shpenzosh më shumë se sa që fiton. Mos harro! - e porositi përsëri nëna.



**Derisa po ktheheshin të hënën nga shkolla, Pupù dhe Mimi papritmas u ndalën tek libraria afër shtëpisë.**

- Shiko Mimi! Këto ngjyra i ka edhe Tina, – foli me lakmi Pupù.**
- Sot më duhej ngjyra e kuqe, unë ia kërkova për pak, por ajo nuk ma dha, – u ankua Mimi.**
- Mos u brengos, unë do t'i blej, pastaj mund t'i përdorim së bashku. Vetëm sa të kontrolloj buxhetin tim - shtoi Pupù me seriozitet.**



Dua t'i kem  
ne unë këto..

- Edhe unë mund të shtoj pak nga paratë e mia. Këtë fundjavë nuk do të shkoj në kinema, - shtoi Mimi.
- As unë! – shtoi Pupu.
- Pra shumë shpejt do të bëhemi me ngjyra sikur ato të Tinës,
- thirrën gjithë gëzim Pupu dhe Mimi.



**Pasi i bashkuan paratë, Pupu dhe Mimi filluan t'i numëronin ato.  
- Si t'ia bëjmë tani? Nuk ka mjaft para tek arka për shpenzime. Ndoshta mund t'i marrë nga arka e kursimeve? Jo, jo, nëna më këshilloi që ato të mos t'i prek në asnjë mënyrë, - foli i brengosur Pupu.**





- Nuk do ta kuptojë askush. Do t'i plotësojë përsëri. Këto janë paratë e mia, - mendohej ta bindte veten Pupu.  
- Ëëë..., nuk di Pupu, ndoshta po gabon. Mendo edhe një herë më mirë. Ne kemi ngjyra. Ato vërtet janë të shkurta, por ne mund t'i përdorim ende, - e këshilloi Mimi.  
Por Pupu nuk dëgjoi dhe prapëseprapë i bleu ngjyrat.



CIRKU BAJ

*në fundjavë  
në qytetin tonë!*



**Të nesërmen në klasë, dëgjoheshin pëshpërима, derisa mësuesja po e vendoste lajmërimin në tabelë.**

**- Fëmijë, në qytetin tonë do të ketë shfaqje cirku në këtë fundjavë. Ne do të shkojmë së bashku. Unë do të bisedoj me prindërit tuaj rreth kohës së nisjes, pagesës dhe gjitha tjerave.**

MBOO



- Urraaa!!!- thirrën nxënësit. – Do të kënaqemi së bashku! - u dëgjuan zërat gazmorë.

Vetëm Pupu e Mimi ishin të pikëlluar. Si do ta paguajnë ata biletën tani? Paratë që i kishin për tërë javën i shpenzuan.



**Sapo hynë në shtëpi, Pupu i tregoi babait të gjitha.**

**- Pupu, tani është vonë për pendim. Duhet të gjejmë ndonjë zgjidhje, - foli i menduar babai.**

**Pas pak, babai tha:**

**- Kam një ide! Sot kthehet nëna nga udhëtimi. Le t'i bëjmë një befasi meqë ajo edhe e ka ditëlindjen, - shpjegoi ai. Ju mund të më ndihmoni.**

**- E çfarë mund të ndihmojmë ne? Ne jemi të vegjël ende, - foli i pikëlluar Pupu.**



- Të vegjël jeni, por jo aq të vegjël për këtë çfarë kam në mendje. Ti Pupu mund të shkruash një poezi për nënën. Asaj i pëlqejnë shumë poezitë. Kurse ti Mimi, mund të na ndihmosh me radhitjen e fotografive familjare në albumin e ri – shpjegoi babai.





**Derisa Pupu po mendohej të shkruante një poezi për nënën, papritmas u dëgjua e qeshura e Mimit.**

- Sa i vogël që je në këtë fotografi Pupu – qeshte Mimi duke vendosur foton në album. – Po këtu kush është? – pyeti ajo përsëri.**
- Të lutem Mimi, mos më pengo, do ta humbas idenë. Kemi ende shumë punë për të bërë, - e qortoi Pupu.**
- Më fal Pupu! - tha me gjysmë zëri Mimi.**



**Pas disa minutash duket se Pupu ia doli të shkruajë poezi për ditëlindjen e nënës. Ndërsa Mimi e përfundoi radhitjen e fotografive në albumin familjar.**

- Mimi, tani do ta lexoj, të lutem më dëgjo dhe më trego si po të duket para se t'ia dorëzoi babait, – e luti Pupu.**
- Pupu, ti qenke një shkrimtar i vërtetë. Nënës tënde do t'i pëlqejë me siguri shumë, – e lavdëroi Mimi. – Edhe unë e përfundova vendosjen e fotografive në album, – tregoi ajo.**
- Ju lumtë fëmijë! Tani ju do të shpërbleheni për punën e bërë, – u dëgjua zëri i babait.**



**Më në fund erdhi koha e numërimit të parave të fituara dhe vendosja e tyre nëpër arkat e duhura. Derisa Pupu dhe Mimi po numëronin monedhat, u hap dera dhe hyri nëna.**

- Ëëë.., Mirëserdhe nënë, - e përshëndeti Pupu si i zënë në faj.**
- Po çfarë po ndodh këtu? – pyeti nëna me habi.**
- E dashur eja ulu dhe çlodhu pak. Shpejt do të sjell një lëng freskues për të gjithë, pastaj do të dëgjosh një poezi të bukur për ditëlindjen tënde nga Pupu, - tha babai me butësi.**





- Më fal nënë! Unë nuk dëgjova këshillat tua për paratë, - foli i penduar Pupu.

Ngjyrat më magjepsen dhe unë harxhova tërë paratë e shpenzimeve dhe disa të kursimeve, - psherëtiu në fund Pupu.

- Oh Pupu! Ti vërtet paske gabuar. Por pasi që e ke kuptuar gabimin, unë po të fali, - tha nëna me qetësi.

- Ti ke kuptuar sa e lehtë është të shpenzosh por edhe sa e vështirë është të fitosh e kursesh, - e ledhatoi nëna Pupun në kokë.

- Tani dua të dëgjoj poezinë nga ti - shtoi nëna.



- Të nesërmen nëna propozoi që të gjithë të shkojnë në cirk së bashku. Fëmijët shikonin gojëhapur shkathtësitë e palaços me topat me ngjyra. Derisa po shikonte shfaqjen, Pupu ndjehej i kënaqur që kishte arritur t'i kthejë paratë e shpenzuara.

-Të jesh kursimtar është vërtet e dobishme, – i tha Pupu Mimit, duke shikuar palaçon. Nëna dhe babai vetëm tundën kokën me pohim!





BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO



EUROPEAN FUND FOR SOUTHEAST EUROPE  
DEVELOPMENT FACILITY

Titulli: "A do të shkojë Pupu në cirk?"  
Hartoi tekstin: Luljeta Rama  
Ilustroi: Leopard Cana

Katalogimi në botim – (CIP)  
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

0875

821.18-93-34

Rama, Luljeta

A do të shkojë Pupu në cirk? / hartoi tekstin Luljeta Rama; ilustroi Leopard Cana. - Prishtinë:  
Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, 2020. – 20 f. : ilustr. ; 22 cm. - (Libri i tretë)

1.Cana, Leopard

ISBN 978-9951-8977-6-1

E drejta e autorit i përket Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nëse përdorni pjesë të këtij botimi, ju lutemi të citoni burimin.  
Realizimi i këtij libri u mbështet nga EFSE Departamenti për Zhvillim.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës  
Adresa: Rr. Garibaldi, Nr. 33 Prishtinë, Kosovë.  
Tel: + 383 38 222 055  
Fax: +383 38 243 763  
e-mail: [info@bqk-kos.org](mailto:info@bqk-kos.org)

# A do të shkojë Pupu në cirk?

**Pupu në garën e vrapimit**

**Pupu shkon në bankë!**

**A do të shkojë Pupu në cirk?**

**Një ditëlindje më ndryshe**

**Pupu ka një ide!**

**Libri i tretë**

[www.edukimifinanciar.org](http://www.edukimifinanciar.org)

Edukimi financiar për nxënësit e klasave I-V

ISBN 978-9951-8977-6-1



9 789951 897761